



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Tik në Mësimin e Gjuhës së Huaj

Ngarkesa: 6kredite; 60 orë mësimore; 30 orë leksione dhe 30 seminare;
Viti / Semestri: , Viti II, Semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Master në “Mësuesi”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndore: Kjo lëndë zhvillon te studentët aftësinë: për të përkufizuar, analizuar dhe shpjeguar koncepte që lidhen me mjetet analoge dhe digjitale të mësimin të gjuhës së huaj; për të punuar me formatin analogë dhe elektronik të librave për mësimin gjuhës gjermane; për të përdorur videoprojektorë, smartphonë dhe smartboard për mësimdhënie; për të dalluar dhe analizuar një informacion të saktë mediatik dhe një burim mediatik edukativ; për të gjetur, përshtatur dhe didaktizuar materiale nga burime të ndryshme të TIK-ut për të arritur objektivat mësimore; për të krijuar dhe përdorur Wikis, Podcast në shërbim të objektivave mësimore: për të përdorur për qëllime mësimore platformat e mësimin në distancë.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të përshtaten me mjedise të ndryshme teknologjike enevoja didaktike dhe të reagojnë me fleksibilitet;
2. Të vlerësojnë në mënyrë kritike efektivitetin e teknologjive digjitale në mësimdhënie dhe të reflektojnë se si këto teknologji mbështesin ose pengojnë procesin e të nxënit;
3. Të përdorin teknologjitë digjitale për të nxitur kompetencën për të nxënë në mënyrë të pavarur dhe autonominë;
4. Të zhvilloj një ndërgjegje të shëndetshme për sfidat etike në trajnimin e të dhënave dhe mjeteve digjitale në mësimdhënie dhe të trajtojnë me përgjegjësi informacionet e ndjeshme.

Rezultate të pritshme:

Lënda “TIK në mësimin e gjuhës së huaj” ofron një panoramë të përgjithshme të punës praktike me materiale mësimore analoge dhe elektronike, mjete digjitale, teknologji dhe elemente të ndryshme mediatike, që përdoren sot në nxitje dhe mbështetje të metodave të mësimdhënies dhe të nxënit të gjuhës gjermane. Studentët do të përftojnë njohuri jo vetëm për përdorimin dhe integrimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit, por edhe për hartimin dhe përzgjedhjen e tipologjisë së ushtrimeve dhe materialeve në përshtatje me teknologjinë e përzgjedhur dhe didaktizimin e tyre. Kjo lëndë ka në fokus të saj edhe ndikimin shoqëror që kanë mediat (veçanërisht shtypi, radio-televizioni, interneti dhe rrjetet sociale), të cilat përdoren si burime për përzgjedhjen e materialeve mësimore, duke i ndërgjegjësuar mësuesit e ardhshëm në rolin që ata luajnë për edukimin mediatik të auditorit të tyre.